

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Nr.03-5477/1
18.12.2025
Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 22, neni 20 paragrafi 1 nënparagrafi 15 dhe nenin 96 paragrafi 2 të Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 23 dhe neni 41 paragrafi 1 nënparagrafi 13 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr. 01-3632/1 datë 22.8.2025, dhe në lidhje me nenin 76-v paragrafi 1, neni 75-gj paragrafi 1, neni 76, neni 76-a paragrafët 2 dhe 8 dhe neni 75 paragrafët 1 dhe 4 të Kodit Zgjedhor "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.40/06, 136/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.98/19, 42/20, 74/21, 215/21, 58/24 dhe 76/24), në përputhje me Konkluzionin nr.02-5464/2 datë 18.12. 2025, Këshilli i Agjencisë në seancën e 23-të mbajtur më 18.12. 2025 , miratoi:

**UDHËZIM PËR TRANSMETUESIT
PËR ZGJEDHJET E PËRSËRITURA PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GOSTIVARIT, KRYETAR TË
KOMUNËS SË VRAPÇISHTËS, KRYETAR TË KOMUNËS SË MAVROVËS DHE ROSTUSH DHE
KRYETAR TË KOMUNËS QENDËR ZHUPË, 2026**

1. Ky Udhëzim shpjegon mënyrën e zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës për reklamim të paguar politik (RPP), shënimi i porositësit të reklamimit, ndarjen e kohës në lajme të Shërbimit publik radiodifuziv (ShPR), prezantimin politik pa pagesë të Shërbimit programor për emetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Shërbimi i Kuvendit) dhe për sigurimin e aksesit në përmbajtje të procesit zgjedhor për Zgjedhjet e përsëritura për kryetar bashkie të Komunës Gostivar, kryetar bashkie të Komunës Vrapçishtë, Kryetar bashkie të Komunës Mavrovë dhe Rostushë dhe kryetar bashkie të Komunës Qendër Zhupë, 2026 (në tekstin e mëtejme: Zgjedhjet e përsëritura lokale 2026).

Reklamim i paguar politik

2. Gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e përsëritura lokale 2026, në rrethin e parë të votimit, transmetuesit mund të emetojnë gjithsej nëntë minuta dhe tridhjetë sekonda (00:09:30) kohë shtesë për reklamim në kohë reale program ekskluzivisht të destinuara për reklamim të paguar politik.

3. Në përputhje me ndarjen e kohës për reklamim të paguar politik në nenin 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor, gjithsej nëntë minuta dhe tridhjetë sekonda (00:09:30) në kohë reale të programit të emetuar, do të shfrytëzohet sipas mënyrës në vijim:

– Në maksimum 4 minuta destinuar për dy partitë më të mëdha politike në qeveri, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë fituan shumicë votash, do të transmetohet reklamim i paguar politik për partinë politike VMRO DPMNE (Koalicioni " Maqedonia Juaj - VMRO DPMNE) dhe partisë politike Lëvizja BESA (Koalicioni VLEN).

– Në maksimum 4 minuta destinuar për dy partitë më të mëdha politike të opozitës, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë fituan më shumë vota, do të transmetohet reklamim i paguar politik për partinë politike LSDM (Koalicioni për Zgjedhjet lokale 2025 - LSDM) dhe partisë politike BDI (Aleanca Kombëtare për Integrim – AKI).

– Në maksimum 1 minutë destinuar për partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk fituan mjaftueshëm deputetë për formimin e grupit parlamentar, do të transmetohet reklamim i paguar politik për partinë politike Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë.

– 30 sekondat e mbetura janë të destinuara për paraqitësin(bartësin) e listës nga grup votuesish Zuljhajrat Demiri.

4. Koha e lejuar për reklama ndërmjet bartësve të listave do të ndahet në bazë të kontratës së nënshkruar paraprakisht ndërmjet tyre Ndërkohë, çdo bartës i listës mund të marrë dhe kohën në total për RPP të kategorisë së saj (4 minuta /4 minuta /1 minutë /30 sekonda), nëse nuk ekziston interes nga ose nuk ka bartës liste që mund të emeton RPP gjatë kësaj kohe, përkatësisht nëse është në përputhje me marrëveshjen e arritur.

5. Nëse kemi rreth të dytë, koha në total për reklamim të paguar politik në kohë reale të programit të emetuar do të varet nga koha për RPP që shfrytëzohet nga bartësit e listave ku kandidati për kryetar komune do të vazhdojnë fushatën zgjedhore në rrethin e dytë. Ndërkohë ndarja e kohës ndërmjet bartësve të listave do të jetë e njëjtë si në rrethin e parë të fushatës zgjedhore.

6. Gjatë nënshkrimit të kontratës për reklamim të paguar politik dhe emetim, transmetuesi duhet të marrin parasysh respektimin e limitit të përgjithshëm të kohës reale të lejuar për çdo kategori të bartësve të listave dhe respektimin në total të kohës së lejuar për RPP në kohë reale të programit të emetuar.

7. Sipas neni 76-v paragrafi 9 të Kodit Zgjedhor, kontratat duhet të përmbajnë të dhëna të qarta mbi periudhat e reklamave, çmimet e reklamave dhe vlerën e kontratave. Secila reklamë e emetuar që është porositur nga bartësit e listave, përkatësisht që nuk përfshihet në kontratën e nënshkruar, do të konsiderohet financim ose si donacion për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore që nuk lejohet në përputhje me nenin 75 paragrafi 7 të Kodit zgjedhor.

8. Në përputhje me nenin 76 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor, në të gjitha format të reklamimit të paguar politik, porositësi i reklamës duhet të shënohet qartë.

9. Si porositës të reklamave duhet të shënohen emrat e saktë të listave të konfirmuara të kandidatëve për kryetarë bashkie të komunave.

10. Në raste kur aplikanti i listës së konfirmuar ka vendosur që pjesë të kohës së marrë për RPP ta shfrytëzon për të mbështur pjesëmarrës të tjerë në fushatën zgjedhore, transmetuesit duhet të shënojnë emrin e saktë të porositësit të reklamës, dhe jo pjesëmarrësit e mbështetur në fushatën zgjedhore.

Ndarja e kohës në lajmet e ShPR

11. Gjatë kohës së fushatës zgjedhoer për Zgjedhjet e përsëritura lokale 2026 , Shërbimi publik radiodifuziv në lajmet do të ndajë segment të veçantë të destinuar për raportimin e aktiviteteve zgjedhore të fushatës, në kuadër të cilit koha do të ndahet sipas parimit të barazisë së kandidatëve për kryetar bashkie.

Prezantimi politik pa pagesë të Kanalit të Kuvendit

12. Gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e përsëritura lokale kanali i Kuvendit do të sigurojë gjithsej tre orë në ditë për prezantim politik pa pagesë të fushatave të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe gjithsej një orë në ditë për prezantim politik pa pagesë për bartësin e listës nga grup votuesish Zulhajrat Demiri.

13. Në gjithsej tre (3) orë për prezantim politik pa pagesë gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e përsëritura lokale, do të emetohet prezantim pa pagesë për partitë politike: VMRO DPMNE (Koalicioni " Maqedonia Juaj), Lëvizja BESA (Koalicioni VLEN), LSDM (Koalicioni për Zgjedhjet lokale 2025 – LSDM), BDI (Aleanca Kombëtare për Integrim – AKI) dhe Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë. Nëse ka rreth të dytë, gjatë kësaj kohe do të emetohet prezantim pa pagesë të kandidatëve për kryetar bashkie të cilët do të vazhdojnë fushatën në rrethin e dytë.

14. Rreth mënyrës së shfrytëzimit të kohës për prezantimin politik pa pagesë do të vendosë Shërbimi programor i destinuar për emetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me politikën redaktuese, për çfarë në kohë do t'i informojë pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore.

Aksesueshmëria e përmbajtjes për procesin zgjedhor

15. Shërbimi publik radiodifuziv dhe televizionet në nivel shtetëror që do të publikojnë reklamim të paguar politik, në përputhje me detyrimet e nenit 75 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të kodit Zgjedhor, përmbajtje lidhur me procesin zgjedhor duhet t'i emetojnë në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.

16. Shërbimi publik radiodifuziv dhe televizionet në nivel shtetëror do të sigurojnë akses në: - së paku një edicion lajmesh, në periudhën nga ora 16:00 deri në orën 24:00, çdo ditë dhe së paku një emisioni tjetër lidhur me procesin zgjedhor, në periudhën nga ora 16:00 deri në orën 24:00, një herë në javë.

Dispozitat përfundimtare

17. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Udhëzim kryhen me shkrim.

18. Ky Udhëzim hynë në fuqi në ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho STEFANOVSKI**